



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI**

Nr. 2324/prot

Koplik më: 04 / 09 / 2025

V E N D I M

Nr 27 datë 03 / 09 / 2025

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 03.09.2025, mbështetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 94/2022 "PËR TITUJT E NDERIT DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" neni 9 pika 1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

VENDOSI

T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi "Z. Gjon Gjinaj (pas vdekje) me motivacionin:

"Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si një kontribues në fushën veterinare dhe atë njerëzore humanitare duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratur me 03.09.2025


Vota Pro 28

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 04.09.2025






REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

Nr. 2329/prot

Koplik më: 27/08/2025

Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe
Propozim për dhënie titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malësi e
Madhe z. Gjon Gjinaj (pas vdekje)



Gjon Gjinaj gjate jetes se tij u dallua si profesionist i afte dhe i shkelqyer ne fushen e veterinarise ne Malesi e Madhe. Gjon Gjinaj nje veteriner i ralle, me dije te thella dhe perkushtim ,duke qene per shume vite i gatshem dhe i pa lodhur qe tu vinte ne ndihme fermere dhe familjeve ne komunitet. Ai u be mbeshtetja e pare dhe me e forta per sherimin dhe shendetin e kafsheve, duke kuruar semundje e duke sheruar bageti. Puna qe ai bente shoqerohej gjithmone me nje dashuri te madhe ,thjeshtesi dhe humanizem , duke krijuar nje autoritet te madh, te dashur e te respektuar kudo qe shkonte. Pervec profesionit te tij Gjon Gjinaj njihet per zemergjersine dhe bamiresit e tij. Ai nuk shërbeu vetëm si mjek veteriner, por edhe si mik, këshilltar dhe mbështetës i njerëzve të thjeshtë. Ai bënte te pamunduren që dhe ne kohë te vështira banorëve të Malesisë se Madhe te ju gjendej pranë. Përmes punës së palodhur, ndershmërisë dhe bamirësisë, ai la pas një trashëgimi me vlera që do të kujtohet me krenari.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malësi e Madhe me

motivacion:

"Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si një kontribues në fushën veterinare dhe atë njerëzore humanitare duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".

